




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr 413 Prot

Elbasan më 13.10.2021

Lënda: Njoftim për vend të lire pune

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarivë të ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Masazheri - 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vëpruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;

f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Te ketë diplome nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në profesionin e kursit për të cilin po aplikon;
- b) Te ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) Te njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përfshijë.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e identitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin të ofrimit publik të AFP-së brenda datës.....11.11. 2021

